REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Akti nga vjen Kuvendi

Nr. 3573 **Prot**

Datë.më 31.07 **2026**

Hyrje në Protokollin e Bashkisë Has me Nr. 2894 **Dt** 03.08 **2026**

Përmbledhje e përmbajtjes

Shkresë përgjellëse.

Në vëmendje të Kryetari

Z/Zj Zv/Kryetari.

Me porosinë

Për zbatim.

Miftar DAUTI

KRYETAR

Adresa:Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani",Qyteti Krumë, Rrethi Has

Tel/Fax: +35521422080, E-mail info@bashkiahas.gov.al

Nr. 2894 Prot
Dt. 03.08.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3573 prot

Tiranë më, 31.07 2026

Lënda: Shkresë përcjellëse

BASHKISË GJIROKASTËR
KËSHILLIT TË BASHKISË GJIROKASTËR

BASHKISË KËLCYRË
KËSHILLIT TË BASHKISË KËLCYRË

BASHKISË LIBOHOVË
KËSHILLIT TË BASHKISË LIBOHOVË

BASHKISË MEMALIAJ
KËSHILLIT TË BASHKISË MEMALIAJ

BASHKISË PËRMET
KËSHILLIT TË BASHKISË PËRMET

BASHKISË TEPELENË
KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË

BASHKISË DROPULL
KËSHILLIT TË BASHKISË DROPULL

BASHKISË DEVOLL
KËSHILLIT TË BASHKISË DEVOLL

BASHKISË KOLONJË
KËSHILLIT TË BASHKISË KOLONJË

BASHKISË PUSTEC
KËSHILLIT TË BASHKISË PUSTEC

BASHKISË DURRËS
KËSHILLIT TË BASHKISË DURRËS

BASHKISË KRUJË
KËSHILLIT TË BASHKISË KRUJË

BASHKISË SHIJAK
KËSHILLIT TË BASHKISË SHIJAK

BASHKISË BELSH
KËSHILLIT TË BASHKISË BELSH

BASHKISË CËRRIK
KËSHILLIT TË BASHKISË CËRRIK

BASHKISË ELBASAN
KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

BASHKISË GRAMSH
KËSHILLIT TË BASHKISË GRAMSH

BASHKISË LIBRAZHD
KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD

BASHKISË PEQIN
KËSHILLIT TË BASHKISË PEQIN

BASHKISË PËRRENJAS
KËSHILLIT TË BASHKISË PËRRENJAS

BASHKISË DIVJAKË
KËSHILLIT TË BASHKISË DIVJAKË

BASHKISË FIER
KËSHILLIT TË BASHKISË FIER

BASHKISË LUSHNJE
KËSHILLIT TË BASHKISË LUSHNJE

BASHKISË MALLAKASTËR
KËSHILLIT TË BASHKISË MALLAKASTËR

BASHKISË PATOS
KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

BASHKISË KORÇË
KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË

BASHKISË MALIQ
KËSHILLIT TË BASHKISË MALIQ

BASHKISË POGRADEC
KËSHILLIT TË BASHKISË POGRADEC

BASHKISË HAS
KËSHILLIT TË BASHKISË HAS

BASHKISË KUKËS
KËSHILLIT TË BASHKISË KUKËS

BASHKISË TROPOJË
KËSHILLIT TË BASHKISË TROPOJË

BASHKISË KURBIN
KËSHILLIT TË BASHKISË KURBIN

BASHKISË LEZHË
KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

BASHKISË MIRDITË
KËSHILLIT TË BASHKISË MIRDITË

BASHKISË FUSHË-ARRËZ
KËSHILLIT TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ

BASHKISË MALËSI E MADHE
KËSHILLIT TË BASHKISË MALËSI E MADHE

BASHKISË PUKË
KËSHILLIT TË BASHKISË PUKË

BASHKISË SHKODËR
KËSHILLIT TË BASHKISË SHKODËR

BASHKISË VAU I DEJËS
KËSHILLIT TË BASHKISË VAU I DEJËS

BASHKISË DELVINË
KËSHILLIT TË BASHKISË DELVINË

BASHKISË FINIQ
KËSHILLIT TË BASHKISË FINIQ

BASHKISË HIMARË
KËSHILLIT TË BASHKISË HIMARË

BASHKISË KONISPOL
KËSHILLIT TË BASHKISË KONISPOL

BASHKISË SARANDË
KËSHILLIT TË BASHKISË SARANDË

BASHKISË SELENICË
KËSHILLIT TË BASHKISË SELENICË

BASHKISË VLORË
KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË

BASHKISË BERAT
KËSHILLIT TË BASHKISË BERAT

BASHKISË KUÇOVË
KËSHILLIT TË BASHKISË KUÇOVË

BASHKISË POLIÇAN
KËSHILLIT TË BASHKISË POLIÇAN

BASHKISË SKRAPAR
KËSHILLIT TË BASHKISË SKRAPAR

BASHKISË DIMAL
KËSHILLIT TË BASHKISË DIMAL

BASHKISË BULQIZË
KËSHILLIT TË BASHKISË BULQIZË

BASHKISË DIBËR
KËSHILLIT TË BASHKISË DIBËR

BASHKISË KLOS
KËSHILLIT TË BASHKISË KLOS

BASHKISË MAT
KËSHILLIT TË BASHKISË MAT

BASHKISË ROSKOVEC
KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC

BASHKISË TIRANË
KËSHILLIT TË BASHKISË TIRANË

BASHKISË KAMËZ
KËSHILLIT TË BASHKISË KAMËZ

BASHKISË KAVAJË
KËSHILLIT TË BASHKISË KAVAJË

BASHKISË RROGOZHINË
KËSHILLIT TË BASHKISË RROGOZHINË

BASHKISË VORË
KËSHILLIT TË BASHKISË VORË

Tiranë

Bashkëlidhur po Ju përcjellim shkresën e një grupi deputetësh, së bashku me projektligjin "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" dhe relacionin shoqërues, për dhënie mendimi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

GENCI GJONÇAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Tiranë, më 30.07.2026

I nderuar zoti Kryetar / E nderuar zonja Kryetare,
Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në emër të grupit të deputetëve propozues të mazhorancës parlamentare, anëtarë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale më lejoni t'ju drejtohem me këtë letër për t'ju paraqitur propozimin për Reformën Administrativo-Territoriale 2.0 dhe për të kërkuar mendimin dhe kontributin tuaj institucional në procesin e konsultimit.

Të nderuar,

reforma administrativo-territoriale e vitit 2014 shënoi një ndryshim themelor në organizimin e pushtetit vendor në Shqipëri. Ajo i dha fund copëzimit të skajshëm të territorit, duke e kaluar vendin nga 373 njësi të qeverisjes vendore në 61 bashki më të mëdha dhe me më shumë mundësi për të ushtruar funksionet e tyre.

Dhjetë vjet më vonë, rezultatet e kësaj reforme janë të dukshme. Të ardhurat e veta të bashkive janë rritur ndjeshëm, detyrimet e prapambetura janë ulur, kapacitetet administrative janë forcuar dhe një pjesë më e madhe e buxheteve vendore është orientuar drejt investimeve dhe shërbimeve për qytetarët. Për herë të parë u ngrit gjithashtu një sistem kombëtar për matjen e performancës së bashkive.

Por pikërisht përvoja e këtyre dhjetë viteve ka nxjerrë në pah edhe sfida të reja. Reforma Administrativo-Territoriale 2.0 nuk është mohim i reformës së vitit 2014 dhe as kthim pas. Ajo është faza e dytë e të njëjtit proces reformues.

Shqipëria e vitit 2026 nuk është më Shqipëria e vitit 2014. Dinamikat demografike, ekonomike dhe territoriale kanë ndryshuar ndjeshëm, ndërsa zhvillimi ndërmjet bashkive mbetet i pabarabartë. Disa bashki kanë mundësi të investojnë, të tërheqin aktivitet ekonomik dhe të ofrojnë shërbime me standarde të larta, ndërsa të tjera përballen me tkurrjen e popullsisë aktive, me të ardhura të kufizuara dhe me mungesë të burimeve njerëzore të specializuara.

Në të njëjtën kohë, përparimi i Shqipërisë në procesin e integrimit europian vendos përpara pushtetit vendor kërkesa të reja. Rreth 70%e legjislacionit europian zbatohet në nivel vendor, në fusha si planifikimi, mjedisi, menaxhimi i mbetjeve, transporti, zhvillimi ekonomik lokal dhe shërbimet publike. Edhe përfitimi nga fondet e ardhshme të kohezionit dhe të zhvillimit rajonal kërkon bashki me kapacitete të forta administrative, teknike dhe financiare.

Përballë këtij realiteti, objektivat tona janë të qarta: bashki efikase dhe me kapacitete reale; bashki të afta të funksionojnë në hapësirën europiane; ruajtja e identitetit vendor; ekuilibri ndërmjet efikasitetit dhe afërsisë me qytetarin; si dhe një zhvillim më i balancuar në të gjithë territorin.

Për të ndërtuar një reformë të mbështetur në fakte dhe në nevojat reale të territorit, Kuvendi ngriti Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale. Që në fillim zgjodhëm një model të pazakontë bashkëpunimi politik: bashkëdrejtimin e Komisionit dhe përfaqësimin e barabartë të mazhorancës dhe opozitës. Ky organizim u zgjodh sepse një reformë që prek organizimin e territorit dhe jetën e komuniteteve nuk duhet të jetë pronë e një pale politike apo e një mandati të vetëm.

Në kuadër të këtij procesi, Komisioni zhvilloi dëgjesa në 11 qarqe dhe dhjetëra takime me qytetarë, kryetarë bashkish, këshilltarë vendorë, përfaqësues të biznesit, universiteteve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit. Mbi 3,500 qytetarë morën pjesë në këto konsultime.

Ju shpreh mirënjohjen time të veçantë për kontributin që keni dhënë në këtë proces. Mendimet, shqetësimet dhe propozimet e drejtuesve vendorë kanë qenë thelbësore për të kuptuar më mirë problematikat e territorit dhe drejtimin që duhet të marrë reforma.

Nga konsultimet doli qartë se qytetarët nuk e shohin reformën thjesht si çështje kufijsh apo hartash administrative. Ata flasin për ujin, rrugën, shkollën, transportin, pastrimin, kujdesin social, kanalet vaditëse dhe cilësinë e shërbimeve. Qytetari nuk jeton në hartë; ai e përjeton pushtetin vendor përmes cilësisë së shërbimit që merr çdo ditë.

Pas përfundimit të mandatit të Komisionit, u gjendëm përpara një zgjedhjeje të qartë: ta linim pa rezultat një proces të nisur, ose ta vijonim atë me përgjegjësi, duke e kthyer dëgjimin, ekspertizën dhe analizën në një propozim konkret. Zgjodhëm të vazhdojmë, sepse Shqipëria nuk mund të humbasë kohë në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe ndërtimit të bashkive europiane.

Propozimi që ju përcjellim është rezultat i analizës së dhjetë viteve të zbatimit të reformës së vitit 2014, i përvojës së krijuar gjatë kësaj periudhe, i dëgjesave publike dhe i punës së ekspertëve të Komisionit. Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni edhe raportin e detajuar analitik të përgatitur nga ekspertët, i cili paraqet të dhënat, gjetjet dhe argumentet mbi të cilat mbështetet propozimi.

Modeli i propozuar ruan bashkinë si të vetmen njësi të vetëqeverisjes vendore, me një kryetar, një këshill, një administratë dhe një buxhet të vetëm.

Organizimi i brendshëm propozohet të kalojë nga skema **Bashki – Njësi Administrative** në skemën **Bashki – Qytet – Njësi Administrative**. Qyteti do të shërbejë si njësi funksionale e planifikimit, përfaqësimit dhe organizimit të shërbimeve. Për çdo qytet propozohet caktimi i një nënkryetari përgjegjës për koordinimin administrativ dhe zbatimin e shërbimeve në territorin përkatës. Nuk krijohet një nivel i ri i pushtetit vendor dhe nuk shtohen struktura apo kosto administrative.

Këshilli bashkiak do të vazhdojë të jetë organi përfaqësues i bashkisë, por përbërja e tij do të pasqyrojë në mënyrë proporcionale peshën demografike të qyteteve përbërëse. Kryetari i bashkisë do të vazhdojë të zgjidhet drejtpërdrejt nga i gjithë trupi zgjedhor i bashkisë, duke ruajtur një ekzekutiv të unifikuar dhe një përgjegjësi të qartë politike.

Ky organizim synon të ruajë identitetin historik dhe qytetar të qyteteve, të forcojë përfaqësimin e tyre politik, të afrojë koordinimin e shërbimeve me komunitetin dhe të krijojë një nivel më të qartë territorial për planifikimin e zhvillimit dhe monitorimin e performancës.

Në përputhje me nenet 89 dhe 90 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ju kërkojmë:

1. Kryetari/ja i/e bashkisë të paraqesë mendimin e tij/saj zyrtar dhe të argumentuar mbi propozimin e bashkëlidhur;
2. Këshilli bashkiak ta shqyrtojë propozimin në mbledhje dhe të miratojë mendimin e tij zyrtar, duke pasqyruar në aktin përkatës edhe qëndrimet kundër ose alternative, nëse ka;
3. Bashkia të organizojë informimin dhe konsultimin e popullatës së territorit të saj, nëpërmjet dëgjesave publike në njësitë administrative, takimeve me banorët dhe instrumenteve të tjera të përshtatshme, si dhe të përmbledhë e të përcjellë zyrtarisht mendimin e popullatës.

Bashkëlidhur gjeni përmbledhjen e propozimit, hartat administrativo-territoriale dhe dokumentacionin argumentues përkatës.

Mendimet dhe dokumentacioni shoqërues lutemi të përcillen brenda 60 ditëve nga data e marrjes së kësaj shkrese, fizikisht ose në adresën elektronike te Kuvendit.

Teksa presim përgjigjen dhe kontributin tuaj, ju ftoj që këtë fazë ta trajtojmë me përgjegjësinë që kërkon një reformë shtetformuese. Reforma e vitit 2014 hodhi themelet për bashki më të forta dhe më funksionale. Sot kemi mundësinë që, së bashku, ta çojmë këtë proces një hap më tej dhe të ndërtojmë bashki europiane: me kapacitete më të mëdha, me përfaqësim më të mirë dhe më pranë qytetarit.

Me konsideratë,

ARBJAN MAZNIKU

DEPUTETËT PROPOZUES

1. Arbjan Mazniku
2. Ermal Kllogjeri
3. Romina Kuko
4. Dritan Bejleri
5. Ermal Pacaj
6. Arlona Xhuxhi
7. Artur Roshi
8. Klevis Balliu
9. Agron Shehaj
10. Adi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 3521 prot. Tiranë, më 30 / 07 / 2026

Lënda: **Depozitim projektligji.**

Drejtuar: **Z. Niko PELESHI**
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar z. Kryetar,

Bazuar në nenin 81, pika 1 dhe 2 shkronja f), 83 pika 1 dhe 108, pika 2 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes për shqyrtim dhe miratim projektligjin "*Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*", së bashku me relacionin shoqërues.

Ky projektligj dhe relacioni shoqërues, në përputhje me nenin 108, pika 2 të Kushtetutës dhe nenet 89 dhe 90 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë", i dërgohet për mendim zyrtar:

(i) Këshillave bashkiak dhe kryetarëve të bashkive që preken nga ky projektligj, pasi përfshihen drejtpërdrejt në riorganizim;
(ii) Këshillit të qarkut ku ndodhen bashkitë që preken nga ky projektligj, pasi përfshihen drejtpërdrejt në riorganizim;
(iii) Këshillit të Ministrave;
(iv) Avokatit të Popullit, Kontrollit të Lartë të Shtetit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komitetit për Pakicat Kombëtare, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil.

Organet e sipërpërmendura japin mendimin brenda 60 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për shprehje mendimi nga ana e propozuesit.

DEPUTETËT PROPOZUES

1. Arbjan Mazniku
2. Ermal Kelli
3. Ramiro Luko
4. Dritan Bejleri
5. Ermal Pacani
6. Arlona Xhuxhi
7. Artur Braka
8. Klevis Balliu
9. Agron Shehaj
10. Adi Rama